





POP 5

Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit



Aksidenti tragjik me 4 viktimë të rruga e Kombit/ Report Tv siguron videon e parakalimit fatal të 'Citroenit' para se të përplasej me kamionin




Atentat si në film/ Momenti kur 2 persona qëllojnë 45-vjeçarin në qendër të Mititit (VIDEO)



Nëna vret 3 fëmijët e saj të mitur dhe më pas veten



A do largoheni nga politika nëse nuk fitoni zgjedhjet? Basha 'hervozohet' me gazetarin: S'është negativ për të gjithë ata që duan të hyjnë në vend



Turqi-Francë bien dakord të rinisin dialogun/ Erdogan i shkruan letër Macron ia kthen turqisht: I dashur Tayyip

Aktualitet

Grabitet kambisti në Korçë! 2 nga autorët marrin 10 mln lekë dhe ikin, i treti kapet nga pronari! Fqinjët: U zgjuam nga ulërimat! Po përlesheshin me njëri-tjetrin (VIDEO)

Një banesë ka rënë pre e grabitjes në orët e para të mëngjesit të kësaj të hëne në qytetin e Korçës. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 06:10, në lagjen nr. 1, në rrugën e "Bilbilave", ku tre persona të maskuar kanë grabitur banesën e kambistit të identifikuar si Shefqet Muço.

- Fqinji: Kambisti ishte i gjakosur në fytyrë, ia hoqa nga duart autorin 'i thashë mos e vrit'
- Grabitja në Korçë/ Zbulohet emri i kambistit! Të afërmit: Është e disata herë që ndodh



Redaksia

11 Janar, 07:26 | Përditësimi i fundit: 11 Janar, 18:07

KORÇË Një banesë ka rënë pre e grabitjes në orët e para të mëngjesit të kësaj të hëne në qytetin e Korçës. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 06:10, në lagjen nr. 1, në rrugën e "Bilbilave", ku tre persona të maskuar kanë grabitur banesën e kambistit të identifikuar si Shefqet Muço.

Report Tv mëson nga burime zyrtare se kanë qenë 3 autorë, 2 prej të cilëve kanë arritur që të marrin një sasi të konsiderueshme të lekëve, e ndërsa i treti është arrestuar, kjo pasi ky i fundit u përlesh me të zotin e shtëpisë, e për pasojë mbeti i lënduar.

[Sh]

LEXO EDHE:
Vodhën 4 mln lekë të reja/ Lihet në burg një prej autorëve që grabiti kambistin në Korçë



Për gazetaren e Report Tv, Gladiola Hoxha, fqinjët tregojnë se u zgjuan në mëngjes nga ulërimat e familjes Muço. Një prej autorëve, aktualisht i arrestuar, është përleshur me Muçon. Ky i fundit ka marrë plagë në kokë, teksa të lënduar ka mbetur edhe gruaja dhe djali tij.



Rendit zhvillimet sipas orarit: **Të Fundit**

Ora 11:45

Grabitja në Korçë/ Zbardhet emri i autorit që u përlesh me kambistin!

Report Tv mëson se autori që ka kryer grabitjen është Agim Çoçi, rreth moshës 50-vjeç. Ai është në spital pasi ka marrë lëndime për shkak se është përleshur me kambistin. Ai është nga Moglica, por banues në Durrës.

Ora 10:41

Grabitja e kambistit në Korçë/ Autorët morën 10 milionë lekë

Detaje të reja kanë dalë në dritë nga grabitja e kambistit në Korçë. Sipas burimeve, mësohet se kambistit i janë grabitur 10 mln lekë.

Ora 08:14

Grabitja në Korçë/ Fqinji: Kambisti ishte i gjakosur në fytyrë, ia hoqa nga duart autorin 'i thashë mos e vrit' (VIDEO)

Një nga fqinjët tregon se si ka ndodhur grabitje, teksa zbulon edhe për përleshjes së kambisti ka pasur me një nga autorët.

"Katër thotë ato, po unë i pashë katër. Pashë vetëm një që Shefqeti e kishte vënë poshtë, Shefqeti i gjakosur këtej, gruaja e goditur, djali i tij ka ndrydhur dorën, unë vajta vetëm sa ia hoqa nga dora. I vajti tjetri me pistoletë i tha lëshoje, Shefqeti i tha "nuk e lëshoj më vrit". U pashë me doreza autorin, për të mos e vrarë fare e hoqa Shefqetin, lëre se vjen policia. E kanë goditur Shefqetin te koka, iu gjend e gjithë lagjja në ndihmë", tregon ai.

Një tjetër fqinj tha se doli jashtë sapo dëgjoji ulërimat dhe i dha ndihmë të zotit të shtëpisë pasi ishte i gjakosur.

"Dëgjova ulërima, dola nga shtëpia, erdha i pashë. Ishte gjakosur i zoti i shtëpisë", rrëfen një tjetër fqinj.

Ora 08:08

Grabitja në Korçë/ Zbulohet emri i kambistit! Të afërmit: Është e disata herë që ndodh



Report Tv mëson se kambisti, banesa e të cilit ra pre e grabitjes orët e para të mëngjesit të sotëm është Shefqet Muço, teksa Report Tv sjell pamje nga vendi i ngjarjes. Sipas dëshmisë së të afërmeve, kjo është e disata herë që ndodh.

B.K./r.k./Shqiptarja.com

TAG: grabitje korce kambisti shefqet muco



Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH

Sondazhi i ditës:
Cilët janë shkaktarët kryesorë të aksidenteve rrugore?

Shoferët Sinjalistika Këmbësorët

Komento


Lajme të tjera

Aktualitet



Tjetër dëshmi rrëqethëse nga Covid2, 'viktima' e Tires: Na kërkoi 50 euro për ta ruajtur babanë! Dhamë 4 mijë euro, por ai vdiq! E çuam 98 kg dhe doli 40 kg!
15 Janar, 22:15

Aktualitet




Policia e Vlorës në aksion, kontrolle për kapjen e të shpallurve në kërkim dhe për armëmbajtje pa leje
15 Janar, 22:01

Aktualitet




VIDEOLAJM/Dëbora shtron qilimin e bardhë edhe në Llogara
15 Janar, 21:37

Aktualitet



Aksidenti tragjik me 4 viktimë të rruga e Kombit/ Report Tv siguron videon e parakalimit fatal të 'Citroenit' para se të përplasej me kamionin
15 Janar, 20:22

Aktualitet



Aeroporti Ndërkombëtar 'Nënë Tereza' liston 11 fluturimet e konfirmuara për nesër
15 Janar, 19:44

Aktualitet



Nis shërbimi për aplikim për pasaportë dhe kartë identiteti në Konsullatën e Shqipërisë në Bari
15 Janar, 19:27

Kodi Etik

Kontakt

Rreth Nesh

Raportoni Ju